

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje nga gjyqtari Naim Kurtishi, me sekretaren juridike Drita Gërmizaj, në çështjen juridike të paditësve I. F. dhe B. A. të gjithë nga Prizreni të cilët i përfaqëson av. Y. K. nga Prizreni, kundër të paditurve M. T., M. A. – T., S., E., R. dhe O. T., H., M. dhe M. T. të gjithë nga Prizreni, lidhur me çështjen e vërtetimit të pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit publik me dt.28.01.2014, në prezencën e palëve morri këtë:

### **A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve, I., F. dhe B. A. nga Prizreni, dhe **VËRTETOHET** se të njëjtit në bazë të mbajtjes në mirëbesim janë bashkëpronar të patundshmërisë - ngastrave kadastrale p.k.nr.5200/3 ZK Prizren - e që është në sipërfaqe prej 8434 m<sup>2</sup> dhe ngastrës p.k.nr.5201/4 ZK Prizren e që është në sipërfaqe prej 600 m<sup>2</sup>, dhe se të paditurit **OBLIGOHEN** që paditësve tu njohin këtë bashkëpronësi në këtë patundshmëri e njëherit tu lejojë që kjo patundshmëri të regjistrohet në librat kadastrale në emër të paditësve si bashkëpronarë, të gjitha këto veprime të paditurit duhet ti kryejnë brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
- II. **OBLIGOHEN** të paditurit që solidarisht të njëjtit paditësve tu paguajnë shpenzimet e procedurës dhe atë në shumë prej 1800 Euro, të cilat duhet ti paguajnë brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Mbetet në fuqi **MASA E SIGURIMIT**, e caktuar me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.642/11 të dt.16.11.2011.

### **A r s y e t i m**

I autorizuari i paditësve nga të dhënat e cekura në padinë e shkruar, si dhe të dhënat e cekura gjatë shqyrtimeve të mbajtura në vazhdimësi si dhe të dhënat e cekura në shqyrtimin përfundimtar të mbajtur me dt.24.01.2014 propozon që kjo kërkesëpadi e paditësve të aprovohet në tërësi dhe nga gjykata të vërtetohet se paditësit në bazë të mbajtjes në mirëbesim e njëherit dhe në bazë të trashëgimisë janë bashkëpronar të patundshmërisë dhe atë ngastrave kadastrale p.k.nr.5200/3 ZK Prizren – sipërfaqe prej 8434 m<sup>2</sup> dhe p.k.nr.5201/4 ZK në Prizren në sipërfaqe prej 600 m<sup>2</sup>.

Po ashtu i autorizuari i paditësve gjatë shqyrtimeve të mbajtura këtë kërkesëpadi e arsyeton me sa vijon: se në bazë të provave materiale gjegjësisht nga shiqimi i listave poseduese me nr.1609 e që është e dt.16.07.1982, vërtetohet fakti se kjo patundshmëri kontestuese ka qenë e evidentuar në emër të të atit të paditësve tani të ndjerit D. A. J. Po ashtu sqaron se me fletposedimin e ri nr.1609 të dt.29.04.2003 kjo patundshmëri kontestuese tani evidentohet si bashkëpronësi me pjesë alikuote 1/3 e në emër të paditësve I., F. dhe B. A., në vazhdim me shiqimin në list.poseduese nr.1609 të dt.19.02.2004 po ashtu kjo patundshmëri kontestuese vazhdon të evidentohet në emër të paditësve. I autorizuari i paditësve sqaron edhe për faktin se këto ngastra kadastrale kontestuese me nr.5200/3 dhe 52001/4 ZK Prizren. Tani në bazë të aktvendimit të marrur nga Agjensia kadastrale e Kosovës nr.03/1072/9 të dt.27.01.2011 e njëjta patundshmëri – kjo kontestuese bartet në emër të paditurve M. T. etj. e në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të kësaj Gjykate komunale në Prizren C.nr.558/89 të dt.08.04.1991 e njëherit sqaron se me këtë aktgjykim në fjalë në cilësinë e palës së paditur ka qenë i përfshirë B. A. e i cili nuk ka qenë pronar i këtyre ngastrave kadastrale kontestuese. Në vazhdim sqaron se me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren E.nr.148/10 të dt.08.02.2011 është lënë jashtë fuqie aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prizren mbi lejimin e ekzekutimit të aktvendimit E.nr.148/10 të dt.08.02.2011 dhe anulohen të gjitha vendimet e ndërmarrura sipas këtij aktvendimi e me arsyetim se aktgjykimi me nr.C.nr.558/89 i dt.08.04.1991 është i pa përshtatshëm për ekzekutim. Bazueshmëria e kësaj kërkesëpadie arsyetohet në faktin se vet paditësi M. T. me deklaratën e vërtetuar në gjykatë Vr.nr.2578/04 të dt.28.06.2004 si dhe paraardhësi i paditurve tani i ndjeri R. T. me deklaratën e vërtetuar në gjykatë Vr.nr.2579/04 të dt.28.06.2004 kanë pranuar se patundshmëria që është në sipërfaqe prej 93,31 ari e që përfshihen në kufij me parcelat kadastrale kontestuese – ato me nr.5200 dhe 5221 asnjëherë nuk kanë qenë pjesë e patundshmërive të paditurve dhe se të njëjtit pra të paditurit nuk kanë shfrytëzuar këto patundshmëri. Në vazhdim i autorizuari i paditësve ka sqaruar se gjatë administrimit të provave kur gjykata ka dalur në vend me prezencën e ekspertëve të angazhuar në këtë çështje, vet palët të paditura konkretisht i padituri M. T. ka sqaruar se një pjesë e këtyre ngastrave kadastrale kontestuese nuk është pronë e tyre e as që të njëjtën ata ndonjëherë e kanë shfrytëzuar. Janë këto arsye ligjore që arsyetojnë kërkesëpadinë përpos arsyerave të lartpërmendura edhe nga fakti se kjo patundshmëri që është objekt kontesti i kësaj kërkesëpadie vetëm me vendim të organin administrativ pra të AKK-ës vendimi nr.03/1072/09 të dt.27.01.2011 është bartur në emër të të paditurve edhe pse siç u sqarua më lartë komisioni pranë shërbimit kadastral në Prizren qysh më herët ka sqaruar se aktgjykimi i Gjykatës komunale në Prizren C.nr.558/89 i dt.08.04.1991 është i pa përshtatshëm për tu ekzekutuar në librat kadastrale nga se pala e përfshirë me këtë aktgjykim – në cilësinë e të paditurit B. A. nuk ka qenë pronarë i kësaj patundshmërie. Me që nuk ka çështje kontestuese se paditësit në vazhdimësi janë në posedim dhe shfrytëzim të kësaj patundshmërie kontestuese, është fjala për patundshmëri që evidentohet qysh herët në librat kadastrale në emër të tyre dhe se është fjala për patundshmërinë e trashëguar nga i ati i tyre tani i ndjeri J. A., paditësit në bazë të trashëgimisë dhe të shfrytëzimit me mirëbesim janë bashkëpronar të kësaj patundshmërie dhe kërkojnë aprovimin e kësaj kërkesëpadie. Njëherit i

autorizuari i tyre ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve por specifikimin e këtyre shpenzimeve e ka paraqitur në formë të shkruar me dt.28.01.2014.

Duke u përgjegjur në të dhënat e kësaj padie të paraqitur nga pala paditëse gjegjësisht i autorizuari i tyre, tani të paditurit njëzëri në përgjegjen e dhënë me shkrim lidhur me këtë padi të paditësve, të dhënat që i autorizuari i tyre i ka cekur gjatë shqyrtimeve të mbajtura, të paditurit po ashtu gjatë shqyrtimeve të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare të shqyrtimit të dt.24.01.2014 janë deklaruar se në tërësi e kontestojnë këtë kërkesëpadi të paditësve duke propozuar që e njëjta nga gjykata të refuzohet si kërkesëpadi e pa bazuar.

Të paditurit dhe të autorizuarit e të paditurve të involvuar në këtë çështje – M. T. përpos tjerash kanë deklaruar se paditësit me asnjë provë nuk kanë argumentuar arsyeshmërinë e kësaj kërkesëpadie, në arsyetim se gjatë të gjitha shqyrtimeve të mbajtura nuk është vërtetuar se paditësit kanë bazë juridike dhe ligjore përfitimi e kësaj patundshmërie nga se me dispozitat ligjore të aplikueshme në mënyrë taksative është rregulluar çështja dhe mënyra e fitimit të pronësisë. Në vazhdim të paditurit sqarojnë për faktin se të njëjtit janë pronar të ligjshëm të kësaj patundshmërie kontestuese nga se me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj Gjykate komunale në Prizren C.nr.558/89 të dt.08.04.1991 e kanë fituar kontestin dhe është vërtetuar se të njëjtit janë pronarë të kësaj patundshmërie kontestuese andaj siç shihet pas marrjes së këtij aktgjykimi në fjalë të njëjtit me aktvendimin e AKK-ës nr.03-1072/09 të dt.27.01.2011 kanë bërë ndryshimin në librat kadastrale dhe kjo patundshmëri pra këto ngastra kadastrale që paraqiten objekt i kësaj kërkesëpadie janë regjistruar në emër të paditurve që ky fakt vërtetohet me shiqimin në certifikatën mbi të drejtat e pronësisë me nr.14385. Po ashtu i padituri M. T. nuk konteston faktin se i njëjti ka dhënë një deklaratë në gjykatë qysh në vitin 2004 kinse nuk është pronarë i këtyre ngastrave kadastrale dhe nuk i kanë punuar këto ngastra por këtë deklaratë e ka bërë në lajthi dhe më vonë të njëjtën deklaratë e ka tërhequr. Janë këto arsye ligjore në bazë të të cilave vërtetohet se kërkesëpadi e paditësve në tërësi është e pa bazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet nga se të njëjtit janë pronarë të ligjshëm të kësaj patundshmërie në fjalë e siç janë deklaruar dhe sqaruar pronësinë në të njëjtat ngastra kadastrale e kanë fituar në bazë të aktgjykimit të kësaj Gjykate komunale në Prizren atë C.nr.558/89. Përpos tjerash kanë kërkuar që gjykata ta revokoi masën e përkohshme të dhënë me vendim nga kjo gjykatë e njëherit kanë kërkuar dhe kompensimin e shpenzimeve në shumë prej gjithsejtë 700 Euro.

Gjykata në këtë çështje juridike bëri administrimin e këtyre provave: është bërë shiqimi në l.p.s. të vjetër me nr.1609 të dt.16.07.1982, shiqimi në lis.posed.nr.të ri 1609 të dt.13.12.2003, shiqimin në flet.posed. e ri e me nr.1609 të dt.29.04.2003, shiqimi në certifikatën gjegjësisht certifikatën mbi të drejtat e pronësisë U1-71813068-01690, është bërë leximi i aktgjykimit të gjykatës komunale në Prizren nr.558/89 të dt.08.04.1991, është bërë leximi i aktvendimit të AKK-ës me nr.03/1072/09 i dt.29.04.2011, është bërë leximi i deklaratës së shkruar dhe të nënshkruar nga M. T. e të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren Vr.nr.2578/04 me

dt.28.06.2004, po ashtu është lexuar deklarata e shkruar dhe e nënshkruar nga R. T. dhe e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren Vr.nr.2589/2004 e dt.28.06.2004, është bërë leximi i deklaratës së shkruar e të nënshkruar nga M. T. dhe e vërtetuar në Gjykatën komunale në Prizren me nr.3044/2006 të dt.23.06.2006, është bërë leximi i vërtetimit të lëshuar nga shërbimi gjeodezisë i Komunës së Prizrenit me nr.952-55/14 dt.14.01.1993, është bërë leximi i aktvendimit të Agjensisë Kadastrale të Kosovës 03564/09 të dt.02.10.2009, është bërë leximi i aktvendimit të Gjykatës së qarkut në Prizren Ac.nr.510/2011 i dt.13.12.2012, është bërë leximi i aktvendimit të Gjykatës themelor në Prizren T.nr.56/09 i dt.18.01.2013, është bërë leximi i procesverbalit E.nr.198/2002 i dt.18.06.2003, është bërë leximi i raportit të dt.11.06.2013 të dhënë nga eksperti gjeometër B. K., është bërë leximi i ekspertizës të dhënë me dt.21.11.2013 nga NP “Geoinfo” në Prishtinë, janë bërë shiqimet në skicat dhe fotot e deponuara nga ekspertët e angazhuar si dhe leximi i aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren T.nr.75/96 të dt.29.05.1996, kështu që me vlerësimin e gjithmbarshëm të të gjitha këtyre provave të administruara si dhe fakteve të vërtetuara, po ashtu me aplikimin e dispozitave ligjore ato të parapara me nenin 7 dhe 8 të LPK gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nga këto arsye:

- Me vlerësimin e provave materiale gjegjësisht me leximin e vendimit të Gjykatës komunale në Prizren T.nr.85/96 të dt.29.05.1996 gjykata vërteton faktin se në këtë aktvendim është shqyrtuar trashëgimia e të ndjerit J. A. dhe se objekt i shqyrtimit të kësaj trashëgimie përpos tjerash kanë qenë dhe ngastrat me nr.5200, 5201 e të tjera me kulturë livadhe si dhe fakti se si trashëgimtarë ligjor pas vdekjes së J. A. janë shpallur të bijtë e tij I., F. dhe B. A. pra këtu palët paditëse. Pra nga këto prova materiale gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit kanë legjimitet aktiv lidhur me inicimin e kësaj çështje juridike pranë kësaj gjykate. Me shiqimin e shkresave të lëndës gjegjësisht shiqimin në l.p.s. me nr.1609 që është i dt.16.07.1982 vërtetohet fakti se në këtë listë poseduese është përfshirë patundshmëria që ka qenë e evidentuar në emër të J. A. e ku janë evidentuar përpos tjerash edhe këto ngastra kadastrale që janë kontestuese në këtë çështje. Në vazhdim sqarojmë se me shiqimin e listave poseduese me nr. të ri 1609 të dt.13.12.2000 dhe dt.29.04.2003 si dhe e dt.19.02.2004 gjykata ka vërtetuar faktin se në emër të paditësve B., F. dhe I. A. evidentohet tërë patundshmëria e përfshirë në këto lista poseduese e ku janë përfshirë edhe këto ngastra kad.nr.5200 dhe 5201.

Vërtetë me leximin e aktgjykimit të Gjykatës komunale në Prizren C.nr.558/89 që është i dt.08.04.1991 gjykata vërteton faktin se është fjala për aktgjykim të pjesërishtëm të marrur nga kjo gjykatë ku me dispozitivin nën I është vërtetuar se paditësit M., R., E., D. dhe M. T. të gjithë nga Prizreni janë pronarët të patundshmërisë nga list.posed. 607 ZK Prizren dhe është fjala për ngastrat kadastrale 13/34 në vendin e quajtur “Kamenica” e në sipërfaqe të përgjithshme prej 90,31 ari e që përfshinë pjesën perëndimore dhe jugore të patundshmërisë së palës së paditur nr.5200 dhe 5201 dhe është obliguar i padituri që ka qenë i involvuar – B. A. që paditësve tu pranohet këtë të drejtë të pronësisë në këtë patundshmëri. Po ashtu me dispozitivin nën II të këtij

aktgjykimi në fjalë është refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë të paditësve që ka të bëjë mbi sipërfaqen e aprovuar prej 90,31 ari, dhe se me dispozitivin nën III të këtij aktgjykimi që ka të bëjë me kërkesën përfitimin e pa bazuar, është lënë për tu vendosur më vonë me vendim të gjykatës. Me administrimin e provave tjera gjegjësisht me leximin e përgjegjës së shkruar të dhënë nga zyra komunale e kadastrit në Prizren që mban nr.protokoli 07-029-11083/Z e që është e dt.04.10.2012 konstatojmë se kemi të bëjmë me një përgjegje të dhënë nga Drejtoria për gjeodezinë e kadastrit të Prizrenit me kërkesën e B. A. e që ka të bëjë vërtetë me regjistrimin e ngastrave kadastrale kontestuese në emër të M. T. e të tjerë, pra me këtë përgjegje ky shërbim kadastral i Prizrenit në komision e nënshkruar nga A. A., R. S., A. R., dhe T. K. kanë sqaruar se ngastrat kadastrale 5200 dhe 5201 sipas programit Bormen i cili ka qenë në fuqi deri me 1995 kanë qenë të evidentuara në emër të J. A. nga Prizreni ndërsa në aktvendimin T.nr.75/96 të dt.19.05.1996 këto ngastra evidentohen në emër të trashëgimtarëve të tij B., I. dhe F. A.. Po ashtu në këtë raport jepen sqarime se Drejtoria për gjeodezi dhe Kadastër pasi që ka pranuar kërkesën e M. T. për evidentimin e këtyre ngastrave në emrin e tij dhe të tjerëve e në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm C.nr.558/89 të dt.09.04.1991 dhe vendimit për ekzekutimin E.nr.198/2002 të dt.18.06.2003 *janë sqaruar se nuk mund ta bëjnë ekzekutimin e këtij aktgjykimi nga se me këtë aktgjykim si palë e paditur ka qenë B. A. i cili nuk ka qenë pronarë i ngastrave të lartcekura por në të kundërtën pronarë të këtyre ngastrave kanë qenë sipas evidencës nga librat kadastrale B., I. dhe F. A.. Po ashtu edhe me këtë raport i njeiti komision ka dhënë sqarime se M. T. dhe vëllau i tij kanë sjellur në këtë shërbim dy deklarata të shkruara ku kanë deklaruar se nuk pretendojnë në këto ngastra që bëhet fjalë me këtë aktgjykim dhe se prona e tyre është në fqinjësi me këto ngastra në fjalë ato parc.kad.nr.5002 dhe 5201. Siç shihet Drejtoria për gjeodezi dhe kadastër ka konsideruar se ky aktgjykim – C.nr.558/89 i dt.09.04.1991 është i pa përshtatshëm për ekzekutim.*

Gjykata në vazhdim sqaron se me leximin e aktvendimit të AKK-ës nr.031072/09 të dt.29.03.2011 vërtetohet fakti se është aprovuar kërkesa e M. T. nga Prizreni për regjistrimin e pronës së paluajtshme e evidentuar të pjesës së parcelës kadastrale me nr.5200 dhe 5201 ZK Prizren në sipërfaqe prej 0.90,31 ha në emër të M., R., E., D. dhe M. T. nga Prizreni sipas dokumentit të plotfuqishëm administrativ dhe gjyqësor. Vërtetë në arsyetim të këtij aktvendimi është cekur se kjo kërkesë është aprovuar nga se M. T. ka ofruar vendimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.558/89 të dt.08.06.1991. Në vazhdim sqarojmë se në bazë të këtij vendimi të AKK-ës është bërë regjistrimi i këtyre ngastrave kadastrale në emër të paditurve M., R., M., E. dhe D. T. sipas certifikatës mbi të drejtat e pronësisë së paluajtshme UL – 71813068-14385.

*Gjykata përpos tjerash bëri administrimin e provave tjera atyre materiale e të deponuara në shkresat e lëndës gjegjësisht me leximin e deklaratës së shkruar dhe të nënshkruar nga M. T. e që deklaratë kjo është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren Vr.nr.2578/2004 të dt.28.06.2004 si dhe të deklaratës së shkruar dhe të nënshkruar nga R. T. e që është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren Vr.nr.2579/04 e dt.28.06.2004, gjykata*

*vërteton për faktin se me këtë deklaratë përpos tjerash është shkruar siç deklarojnë nënshkruesit se ne kemi theksuar edhe gjatë ekzekutimit qysh me dt.18.06.2003 në lëndën E.nr.198/2002 duke sqaruar gjykatën se patundshmëria jonë është ndërmjet lumit, asfalti dhe ngastrave nr.5200 dhe 5201, në thellësi dhe se nuk kemi punë me ngastrat 5200 dhe 5201, dhe se shërbimi kadastral nuk duhet të bëjë pengesa për I., F. dhe B. A. në shfrytëzimin e patundshmërive të tyre të regjistruara si ngastra kadastrale 5200 dhe 5201, njëherit me këto deklarata janë sqaruar nënshkruesit e tyre se duhet bërë përmirësimi i aktgjykimit të Gjykatës komunale në Prizren dhe të vërtetohet se neve jemi pronarë të ngastrës nr.3/34 në sipërfaqe prej 90,31 ari sipas aktgjykimit në kohën kur është marrur i njejt.*

Gjatë administrimit të provave lidhur me këtë çështje juridike gjegjësisht me shiqimin e vendit nga ana e gjykatës e në prezencën e palëve të involvuara si dhe ekspertit gjeometër të angazhuar, shiqimi i vendit i bërë me dt.11.06.2003 ku gjykata ka konstatuar se këto patundshmëri kontestuese ndodhen përkaj rrugës së asfaltuar në drejtim Prizren – Suharekë dhe atë përballë pompës së Benzinit “Breu Petroll” dhe këto patundshmëri janë me kulturë “djerinë” dhe në pjesën e poshtme ndodhen shtëpitë e paditësve. Po ashtu sqarojmë për faktin se personalisht i padituri M. T. me rastin e shiqimit të vendit po këtë ditë është deklaruar ashtu si është shënuar me procesverbal se atë sipërfaqe që është si djerinë fare nuk e shfrytëzojnë të paditurit e njëherit tërë këtë patundshmëri të njëjtit nuk e shfrytëzojnë rregullisht për 43 vite me radhë që nga viti 1969 e këndej.

Gjykata gjatë vendosjes në këtë çështje ka caktuar ekspertët e gjeodezisë të cilët së bashku me gjykatën kanë dalur në vend dhe se me leximin e raportit të dhënë me shkrim nga eksperti gjeometër i angazhuar – B. K. gjykata konstaton me sa vijon **“eksperti në fjalë në këtë raport sqaron se sipas të dhënave me të cilat disponon ZKK në Prizren parcela kadastrale me nr.5200/3 në vendin e quajtur “Kamenica” në sipërfaqe prej 8438 m2 dhe parc.kad.nr.5201/4 në të njëjtin vend në sipërfaqe prej 600 m2 evidentohet si pronë e bashkëpronarëve M. T. 1/5, R. T. 1/5, M. T., E. T. 1/5 dhe D. T. 1/5 që evidentohen sipas certifikatës mbi të drejtat e pronës me nr.14385 dhe se kjo bartje është bërë në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.558/1989 dhe aktvendimit të Komisionit për rindërtim të Agjensionit Kadastral të Kosovës me nr.03/14702/09”**.

Po ashtu me leximin e ekspertizës të dhënë në formë të shkruar nga NPP “Geoinfo” e të nënshkruar nga M. M. inxh. i gjeodezisë gjykata vërteton faktin se po ashtu dhe me këtë ekspertizë konstatohet e njëjta gjendje sikurse që është deklaruar eksperti gjeometër B. K., **“njëherit me këtë ekspertizë është sqaruar se “pas analizës komplete të lëndës që u është dhënë për të dhënë ekspertizën e tyre, vijnë në përfundim se aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.558/89 i dt.09.04.1991 ka ardhur në bazë të shënimeve të kadastrit përshkrues, i cili kadastër për momentin nuk ekziston, sepse në tetor të vitit 2007 është djegur. Edhe po të**

***ekzistonte elaborati kadastral përshkrues ne mendojmë se është e pa mundur që në bazë të kësaj matje saktë të definohen ngastrat 3/34 dhe se me cilat kadastra kadastrale të matjes klasike të vitit 1958 bënë pjesë parc.3/34”.***

Me vlerësimin e gjithmbarshëm të të gjitha këtyre provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga fakti se, nga dëshmia që ka dhënë vetë i padituri M. T. në procesverbalin e dt.11.06.2013 është konstatuar se ai dhe familja e tij nuk e shfrytëzojnë këtë patundshmëri kontestuese që nga viti 1969 e këndej përplot 43 vite e më tepër. Njëherit nga deklarata e shkruar dhe e vërtetuar në gjykatë Vr.nr.2578/04 e dt.28.06.2004 vetë nënshkruesi i kësaj deklarate M. T. është deklaruar se ngast.kad.nr.5200 dhe 5201 nuk janë pronë e tyre dhe se patundshmëritë e tyre ndodhen afër këtyre ngastrave, e njëherit deklarata të njejtë dhe me të njëjtën përmbajtje e ka dhënë dhe nënshkruesi i kësaj deklarate Vr.nr.2579/04 i dt.28.06.2004 R. T. tani i ndjeri.

Njëherit gjykata konstaton se nga provat që janë administruar dhe faktet që janë vërtetuar nuk është kontestues fakti se këto dy ngastra kadastrale kontestuese janë në shfrytëzim të paditësve, por tani të evidentuara në emër të të paditurve. Po ashtu gjykata konstaton se nga këto prova të administruara siç ka elaboruar gjykata duke dhënë arsyeza si në arsyetim të këtij aktgjykimi, gjykata konstaton se për momentin kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e bazuar.

Arsyeshmëria e kësaj kërkesëpadie është e bazuar në kuptim aplikimit të dispozitave ligjore të aplikueshme për rastin konkret gjegjësisht aplikimin e dispozitave të LTHMPJ ***“Gaz.zyrtare nr.6/80 RSFJ-ës” përndryshe dispozita ligjore këto që janë të zbatueshme lidhur me këtë rast edhe në bazë të rregullores së UNMIK-ut 1999/24. Pra sipas dispozitave ligjore të parapara me nenin 20 po të këtij ligji të zbatueshëm – LTHMPJ, ku në mënyrë taksative është paraparë “shfrytëzuesi me mirëbesim të patundshmërisë, e në të cilën patundshmëri personi i tretë ka të drejtën e pronësisë, i njejtë e fiton të drejtën e pronësisë në bazë të parashkrimit me kalimin e afatit kohorë mbi 20 vite”.***

Gjatë administrimit të provave në këtë drejtim posaçërisht me vlerësimin e dëshmisë që ka dhënë vetë i padituri M. T. në procesverbalin e dt.11.06.2003 vet i padituri në fjalë dhe si i autorizuar i të paditurve tjerë është deklaruar se këto ngastra kadastrale të njëjtit nuk i kanë shfrytëzuar më shumë se 40 vite që nga viti 1969. Në drejtim të këtij fakti gjykata ka konstatuar se vetë M. T. e njëherit dhe tani i ndjeri R. T. me deklaratat e shkruar kanë deklaruar se këto ngastra kadastrale – ajo 5200 dhe 5201 nuk janë pronë e tyre dhe se patundshmëria e tyre ndodhet në afërsi të këtyre ngastrave. Pra siç është konstatuar dhe siç është vërtetuar paditësit janë bashkëpronarë të këtyre ngastrave kadastrale si është sqaruar tani në bazë të parashkrimit fitues sipas dispozitave ligjore ashtu si u konstatua më lartë nenit 20 LTHMPJ-ës të zbatueshëm e njëherit dhe me dispozitat ligjore të ligjit të aplikueshëm – nr.03/L-154- Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore të Rep. së Kosovës, ***“ku me nenin 40 al.1 në mënyrë taksative është***

*paraparë se personi i cili me mirëbesim e ka 20 vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj e fiton pronësinë në te*". Njëherit gjykata konstaton edhe për faktin jo kontestues se me vendimin e Gjykatës komunale në Prizren T.nr.85/96 të dt.29.05.1996 kur është shqyrtuar trashëgimia e të ndjerit **J. A.** – dhe se objekt shqyrtimi si masë e trashëgimisë kanë qenë edhe ngastrat kad.nr.5200 dhe 5201, e njëherit si trashëgimtarë të vetëm të kësaj patundshmërie janë shpallur të bijtë e tij – këtu paditësit I., F. dhe B. A. e që jep me kuptuar se të njëjtit edhe në këtë bazë ligjore janë bashkëpronarë të kësaj patundshmërie kontestuese.

Vendimi mbi shpenzimet është marrur në kuptim të nenit 452 të LPK ku janë llogaritur shpenzimet e paditësve dhe të autorizuarit të tyre, e të llogaritura sipas TA-së së aplikueshme, pra shpenzimet për padi, për taksat gjyqësore dhe shpenzimet për përfaqësim nga i autorizuari i tyre si dhe shpenzimet e daljes në vend.

Vendimi mbi masën e përkohshme është marrur në kuptim të dispozitave ligjore të parapara me nenin 309 të LPK.

Janë këto arsyeza ligjore në bazë të të cilave gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.642/11 dt.28.01.2014**

**Sekretarja juridike**  
**Drita Gërmizaj**

**Gj y q t a r i**  
**Naim Kurtishi**

**UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë brenda 15 ditësh nga dita e marrjes, ankesa i dorëzohet kësaj gjykate.**